



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Dega në Prizren

## RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VETËVLERËSIMIN E STAFIT AKADEMIK

**Kolegji Biznesi**

Dega: Prizren

Viti akademik 2024/2025

## 1. Hyrje

Kolegji Biznesi në Prishtinë dhe dega në Prizren si Institucion i arsimit të lartë i themeluar që nga viti 2004, ka ndërtuar dhe zhvilluar vazhdimisht një sistem të qëndrueshëm për sigurimin dhe avancimin e cilësisë akademike dhe institucionale.

KB zbaton mekanizma të rregullt për matjen dhe monitorimin e cilësisë, të cilët përfshijnë rolin e Dekanit, përgjegjësve të programeve studimore dhe koordinatorëve të cilësisë në nivel programi, si dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë (ZSC), e cila përbën organin qendror institucional për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.

Në vitin akademik 2024/2025, në kuadër të ciklit vjetor të sigurimit të cilësisë dhe në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve akademike dhe menaxheriale, ZSC realizoi pyetësin për vetëvlerësimin e stafit akademik. Ky instrument synonte të mbledhë vlerësime të strukturuar mbi cilësinë e mësimdhënies, kushtet e punës akademike, mbështetjen institucionale, zhvillimin profesional dhe funksionimin e mekanizmave të brendshëm të cilësisë.

Procesi i hartimit, shpërndarjes dhe mbledhjes së pyetësorëve u administrua në tërësi nga ZSC, duke garantuar anonimitetin e respondentëve, konfidencialitetin e të dhënave dhe integritetin e procesit, në përputhje me politikat e brendshme të KB-së për sigurimin e cilësisë dhe etikën institucionale.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar në mënyrë statistikore dhe cilësore dhe shërbejnë si bazë për identifikimin e pikave të forta, fushave për përmirësim dhe për formulimin e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Në këtë raport publikohen vetëm gjetjet kryesore të përgjithshme, ndërsa rekomandimet dhe komentet e detajuara, të dhëna në mënyrë konfidenciale nga stafi akademik, përdoren për qëllime të brendshme të planifikimit strategjik dhe përmirësimit të cilësisë, duke respektuar etikën profesionale dhe dinjitetin e secilit pjesëmarrës.

## 2. Metodologjia e Pyetësorit

Pyetësori për stafin akademik është hartuar dhe realizuar në vitin akademik 2024/2025, në përfundim të semestrit dimëror, nga **Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC)** e Kolegjit Biznesi. Pyetësori ka përfshirë profesorët dhe asistentët e të gjitha Programit studimor të Kolegjit Biznesi në Prizren, **PS Banka dhe Financa me Biznes**.

Në këtë proces kanë marrë pjesë **12 respondentë**, të cilët kanë plotësuar **12 pyetësorë** lidhur me kushtet e punës, rezultatet e punës akademike dhe funksionimin e administratës. Të gjithë respondentët kanë dhënë përgjigje për secilën çështje të

parashtruar. Pyetësi ka qenë **anonim**, në përputhje me standardet e etikës akademike dhe të konfidencialitetit institucional.

Pyetësi ka përmbajtur gjithsej 23 pyetje me alternativa, nga të cilat:

- ✓ 9 pyetje për kushtet e punës,
- ✓ 9 pyetje për rezultatet e punës, dhe
- ✓ 5 pyetje për administratën,

Me një mundësi zgjedhjeje për secilën pyetje.

ZSC ka realizuar përpunimin e të dhënave në tabelë përmbledhëse, ndërsa grafikonet janë gjeneruar në mënyrë automatike, për të siguruar paraqitje objektive dhe të verifikueshme të rezultateve.

Pyetjet janë dizajnuar për të vlerësuar këto aspekte kryesore:

- Kushtet e punës;
- Informimin e përgjithshëm;
- Proceset e vendimmarrjes;
- Hapësirat, ambientin dhe pajisjet teknologjike;
- Realizimin e objektivave të planprogramit;
- Menaxhimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor;
- Motivimin dhe integrimin brenda Kolegjit;
- Zhvillimin profesional, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete shkencore;
- Komunikimin dhe informimin nga administrata;
- Sfidat dhe nevojat për përmirësimin e kushteve dhe performances

### **3. Gjetjet nga pyetësi**


Angazhimi i stafit akademik në pyetësin e realizuar gjatë vitit akademik 2024/2025 konsiderohet i kënaqshëm dhe përfaqësues. Stafi ka demonstruar një nivel të lartë bashkëpunimi në procesin e vetëvlerësimit, duke i trajtuar pyetjet me seriozitet dhe duke ofruar përgjigje të plota në të gjitha fushat e adresuara.

Ky raport paraqet vetëm përmbledhjen e të dhënave statistikore dhe rekomandimet kryesore që rezultojnë nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve. Ndërkohë, raportet e detajuara analitike, të përgatitura nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC), janë dorëzuar


tek Dekani dhe do të shërbejnë si bazë për diskutime të strukturuar me stafin akademik, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe institucionale. Në vijim paraqiten gjetjet kryesore nga disa prej pyetjeve dhe fushave specifike të pyetësorit të realizuar me stafin akademik për vitin akademik 2024/2025.

### Pyetësori për vlerësimin e kushteve të punës


Unë jam i/e kënaqur me kushtet e punës të ofruara nga Kolegji. (12 pytesorë)




Unë gjej mbështetje te menaxhmenti për çdo vështirësi dhe sfidë eventuale (12 pytesorë)




Ngarkesa ime e punës është lehtë e menaxhueshme (12 pytesorë)




Unë jam në dijeni për misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike të Kolegjit (12pytesorë)




Unë marrë pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Kolegjit (12 pytesorë)




Unë jam i/e lirë të shpreh idetë dhe propozimet te menaxhmenti i KB (12 pytesorë)




Hapësira e Kolegjit plotëson kushtet për realizimin e mësimit efektiv (12 pytesorë)




Hapësira është e furnizuar me pajisje adekuate për realizimin e mësimit (12 pytesorë)




Unë arrij që të prezantoj në mënyrë të saktë qëllimin dhe objektivat e planprogramit (12 pytesorë)




Unë menaxhoj me lehtësi provimet dhe vlerësimet e studentëve (12 pytesorë)




Numri i studentëve në sallë është i përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor (12 pytesorë)




Unë ndjem i/e motivuar për punën time si mësues në KB (12 pytesorë)




Unë ndjem i/e integruar brenda Kolegjit (12 pytesorë)




KB organizon mjaftueshëm konferenca shkencore për stafin akademik (12 pytesorë)




KB organizon mjaftueshëm aktivitete për zhvillimin e stafit akademik  
(12 pytesorë)  
Deri diku  
2%




Unë jam i/e kënaqur me mundësitë e ofruara nga KB për zhvillimin  
personal (12 pytesorë)  
Deri diku  
2%




Komunikimi me administratën është efektiv (12 pytesorë)  
Deri diku




Sjellja e zyrtarëve administrativë është korrekte dhe profesionale (12 pytesorë)



Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ (12 pytesorë)



Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ (12 pytesorë)



## **Rekomandimet – Dega Prizren**

Pas shqyrtimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit të stafit akademik, **Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Biznesi – Dega Prizren** i rekomandon menaxhmentit të institucionit që gjatë vitit 2023 të fokusohen këto veprime:

- **Nxitja e përdorimit të mjeteve digjitale në mësimdhënie**  
Të inkurajohet përdorimi i mjeteve digjitale dhe platformave mësimore ekzistuese për të përmirësuar organizimin e ligjëratave dhe rritur ndërveprimin me studentët në Degën Prizren.
- **Mbështetja e zhvillimit profesional të stafit akademik**  
Të mbështetet pjesëmarrja e stafit akademik në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional, në përputhje me nevojat dhe kapacitetet e Degës Prizren.
- **Nxitja e mobilitetit për stafin akademik dhe studentët**  
Të inkurajohet pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në programe mobiliteti, veçanërisht në kuadër të projekteve Erasmus+, me qëllim shkëmbimin e përvojave, avancimin profesional dhe ndërkombëtarizimin e Degës Prizren.